

BARDHUL TODA

**E FOLMJA E ELBASANIT DHE DISA SHQYRTIME MË TË
REJA RRETH SAJ**

Gjuha është mjet i domosdoshëm komunikimi, pa të cilin zhvillimi njerëzor nuk do të ishte në nivelin e derisotëm. Edhe pse lindi pas krijesës njerëzore, me format e para primitive të saj me shenja e tinguj pa formë, gradualisht u formësua nga njerëzit me fjalë e më pas në lidhje fjalish, të cilat, si rezultat, na sollën tekstet, që tashmë janë të pa fund. Gjuha në fillim të shekullit të shkuar, nisi të studiohet me metoda shkencore, si formë dhe strukturë, si mjet dhe lëndë parësore komunikimi, ku meritë e veçantë për këtë i takon gjuhëtarit francez Ferdinand de Sossy (*Ferdinand de Saussure*).

*“Gjuha filloi të krahasohet me organizmat e gjallë: ashtu si këto organizma ajo lind, lulëzon dhe shuhet. Gjithë historia e gjuhës edhe e degëzimeve të saj paraqitet në formën e një druri gjenealogjik.”*¹

Brenda një gjuhe edhe pse baza e kuptueshmërisë është e lartë, janë të pranishme disa lloje të folmesh e dialektesh, të cilat karakterizojnë edhe zonat përkatëse sipas mënyrës së të folurit të saj. *Dialektet dhe të folmet e gjalla përbëjnë dëshmi dhe fakte me shumë rëndësi, që kanë apo vlerë të krahasueshme me atë vlerë që kanë bimët për botanistin apo objektet dhe veshjet (kostumet) popullore për etnografin, si këngët e vallet për historianin.”*²

Jorgji Gjiniari, në *“Dialektologjia shqiptare”*, Tiranë 1970, thekson:

“Njësia e gjuhës dhe copëtimi i saj në dialekte, janë të lidhur me rolin që ka gjuha si mjet marrëdhëniesh. Diferencimi i dialekteve dhe kufijtë midis tyre, pasqyrojnë kufijtë e marrëdhënieve që kanë lindur historikisht brenda një kolektivi shoqëror të njëjtë. Duke u nisur nga kjo që thamë, dialektet territoriale të një gjuhe janë “degëzimet” e saj, gjë që ka ardhur si rezultat i diferencimit në kushtet e dobësimit të marrëdhënieve brenda kolektivit. Kështu në këto “degë” të gjuhës së përbashkët duken veçori gjuhësore diferencuese. Këto ndryshime prekin të gjitha sferat e gjuhës: fonetikën, morfologjinë, sintaksën dhe leksikun.

Me termin e folme, kuptojmë atë varietet të gjuhës që është më i imtë dhe që s’ka se si të “ndahet” më tej. Me termin dialekt, kuptojmë varietetin më të madh, tërësinë e të folmeve që kanë karakteristika të përbashkëta.

¹ Shezai Rrokaj, *Strukturalizmi klasik në gjuhësi*, SHBLU, Tiranë, 2002, f. 20.

² J. Gjiniari, *Dialektet e shqipes*, Tiranë, 1980 dhe, Jorgji Gjiniari & Gjovalin Shkurtaç, *Dialektologjia*, botim i dytë i përmirësuar, Tiranë, 2003, f. 13.

Del pra se, *dialekti është një varietet i gjuhës së përbashkët, që i shërben si mjet komunikimi një kolektivi pakashumë të vogël, përfaqësuesit e të cilët kanë marrëdhënie të përbashkëta në mënyrë të drejtpërdrejtë*.³

Gjeografikisht Elbasani ndodhet në mesin e Shqipërisë, pra është qytet i Shqipërisë së Mesme. Qyteti kufizohet në jug me lumin Shkumbin, lum i cili në hartën dialektore përcakton edhe kufirin midis dy dialekteve të mëdha të shqipes, në veri gegërishtja, dhe në jug të tij toskërishtja. Në dialektin verior në grupet e të folmeve bën pjesë edhe gegërishtja e Shqipërisë së Mesme. Të gegërishtes së Shqipërisë së Mesme janë të folmet e Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit.

Të folmet e këtij grupi nuk kanë ndonjë tipar tjetër specifik veç formave të përemrave pronorë *im, ime, tat, tate* (çuni *im, goca ime, çunit tat, gocës tate*), dhe auristit sigmatik (*u lodhesh, u lash*), formës së rasës vendore (*n'malt, n'groat* etj.), kemi diftongjet **ue>u, ye>y, ie>i, oe>e, ae>e**.

Dialektet dhe të folmet e një gjuhe pasqyrojnë të kaluarën e njerëzimit në përgjithësi e të një bashkësie shoqërore në veçanti. Elbasani tani përveç gjuhës standarde ka dhe dy dialekte brenda. Kjo, ngaqë kemi një dyndje të popullsisë në Elbasan, si nga jugu dhe veriu. Këtu kemi një përzierje, një këmbim nga të gjitha palët. Sigurisht ata që vijnë në Elbasan mundohen të përshtaten. Fillimisht ato marrin nga Elbasani dhe me kalimin e kohës ato i ngjiten atij. Kemi një zbehje disi të asaj të folmeje që ato përfaqësojnë. Të folmen e tyre ato do ta ruajnë në rrethin shoqëror të tyre, në fis, në familje, ndërsa në jetën e përditshme, jashtë, ato do të flasin ndryshe, do të arrijnë gjuhën standarde. Ndërsa Elbasani do të ketë një zgjerim njohurish, si në dialektin e gegërishtes edhe në atë të toskërishtes.

Ndryshimet nisin më së pari në sistemin leksikor. Gjuha synon përherë t'u përshtatet më mirë nevojave kumtuese të folësve. Mbi këtë bazë del e qartë se nuk ka zhvillim leksikor në vetvete e për vete, por ka shndërrime e shtresëzime të paprera e të ndërgjegjshme të shkaktuar gjithnjë nga nevojat gjithnjë në rritje të folësve për të kumtuar. Pra, nuk është fjala *qumsht* që ndërron kuptimin, nuk janë trajtat *nërmjet, mush, qas* që riplotësohen në *ndërmjet, mbush, ngas* etj., por është njeriu, folësi që, për arsye të zgjerimit të kumtimit dhe në përputhje me rrethana tashmë cilësorisht më të ngritura, rreshtet me ndërgjegje nga fjalët e trajtat e ngurta dialektore dhe parapëlqen ato që janë normative⁴.

Studiues të ndryshëm kanë nxjerrë si përfundim që nuk ka vija të prera midis dialekteve, sikundër edhe dialektet janë gjuhë. Kjo mund të thuhet sepse

³ Jorgji Gjinari, *Dialektologjia shqiptare* (dispensa), Tiranë 1970, f. 7.

⁴ Gjovallin Shkurtaj, *Vëzhgime mbi shtresat leksikore dialektore e letrare në të folmen e Lezhës*, Studime filologjike 3, Viti XXXV (XVIII), Tiranë, 1981, f. 162-163.

dialekti nuk është “nënprodukt” i gjuhës kombëtare, por një copë a pjesë tërësore e saj, një sistem komunikimi i kryer dhe i pavarur, ndonëse ka një numër më të kufizuar folësish. Përkufizimin më të saktë për dialektin ndër ne mëton ta ketë dhënë Jorgji Gjinar: “*Dialekti është një variant i një gjuhe, i cili shërben si një mjet komunikimi për një kolektiv pak a shumë të vogël njerëzish, përfaqësuesit e të cilit kanë marrëdhënie të drejtpërdrejta në një territor të caktuar*”.⁵

Tipar fonetik në të folmet e gegërishtes veriore është se *e*-ja e gjatë, shqiptohet si *e*. Në të folmet perëndimore të Shqipërisë së Mesme (anët e Tiranës, Durrësit) ajo del e hapur në fjalët ku ndodhet para grupeve të bashkëtingëlloreve *t, ll, r, dh*, p.sh.: *vetlla* “vetulla”, *petlla* “petulla”, *t verdha* “të verdha” etj. Fonema /a/ gojore shqiptohet me timbër buzor (a°) kur ndodhet pas bashkëtingëlloreve hundore *m* e *n* (ma°l “mal”, ina°t “inat” etj.). Shqiptimi i zanores, fonemës *a* hundore [â], vërehet se kjo zanore e serisë hundore shqiptohet e buzorizuar në masë të ndryshme, sa vende-vende arrin t’i afrohet zanores *o* (në të folmet e Tiranës), p.sh.: *dhâ°m* “dhëmb”, *hâ°na* “hëna”, *zâ°* “zë”. Fonema *a* gojore (e shkurtër ose e gjatë) kur ndodhet pas një bashkëtingëllores hundore, shqiptohet më e prapme dhe me një timbër buzor në të folmet e Elbasanit, ashtu edhe të Tiranës: *ma°l* “mal”, *kna°qem* “kënaqem”, *ma°rin* “marrin”. Masa e timbrit buzor është aq e madhe, sa jepet përshtypja sikur *a*-ja shqiptohet si *-o-*. Fonema *-i-* në të folmet Elbasanit, ashtu edhe të Tiranës në vend të kësaj zanoreje del *y*-ja në ato fjalë ku gjendet para një bashkëtingëllores buzore *b, p, m*: *rryp* “rip”, *lyp* “lip”, *qylm* “qilim”, *kry:p* “kripë”, *ly:m* “limë”. Në të folmet Elbasanit, ashtu edhe të Tiranës shpesh *u*-ja (e patheksuar) nuk shqiptohet edhe në një rrokje nistore të hapur: *mllar* “mullar”, *mloj* “mbuloj”, *zllum* “zullum”, *fqi* “fuqi”, *ksur* “kusur”.

Midis dy dialekteve të shqipes, një nga dallimet mes gegërishtes dhe toskërishtes është theksi. Në toskërisht fjalët që janë huazuar nga turqishtja kanë theksin në fund të fjalës si: *kafé, penxheré, çifté, gajdé, havalé, tenxheré* etj., ndërsa në gegërisht janë me theks parafundor. Theksi tipik i gjuhës është parafundor, me këtë përputhet gegërishtja p.sh. *kolláre, bereqávës, hállva, qábe, kdaréja* etj.

Në të folmen e Elbasanit, theksi i fjalëve ndjek rregullin e përgjithshëm brenda shqipes, me theks dinamik parafundor, pa përjashtuar rastet kur ky theks lëviz, si rezultat i zhvillimeve apo veçorisë së brendshme të gjuhës.

Veç fjalëve me theks të përgjithshëm parafundor, fjalë me theks nistor në të folmen e Elbasanit është toponimi Gjinar, fshat i cili është dhe qendra e krahinës së *Shpatit*. Në të gjitha mediat kryesore të vendit deri sot, përjashtuar ato të Elbasanit, këtë emër e dëgjojmë me ndryshim theksi, nga nistor në

⁵ Gjovalin Shkurtaç, *Dialektologji e shqipes*, MORAVA, Tiranë, 2012, f. 19.

parafundor Gjinarí, gjë e cila për këtë toponim, bie ndesh me theksin e të folmes si të krahinës vetë, ashtu edhe me të folmen e Elbasanit. Po kështu si shkak i theksit dinamik, në këto të folme (si në fshat e qytet), kemi rënie të gjysmëzanores -ë- veçanërisht në të folmen e fshatrave të këtij qarku -*flli*q-, -*kna*q-, -*bzaj*-, -*shlla*-, -*knoj*-, -*pshtyj*/n-, etj., fenomen që ndodh edhe në një pjesë leksikore të të folmes së qytetit si p.sh.: *planc* (plëndës), *lçoj* (lëshoj), *kpus* (këpus), *pkuc* (këpucë) *knaq* (kënaq) etj. Si faktor kulturor nga kontakti më i dendur që ka qyteti me gjuhën letrare në krahasim me fshatin, në fjalët e marra si shembull -*flli*q-, -*kna*q-, -*bzaj*-, -*shlla*-, -*knoj*-, -*pshtyj*/n-, *pleq*ní, të cilat edhe sot janë pjesë e leksikut në të folmen e fshatrave, në të folmen e qytetit ka disa ndryshime të vogla në futjen e gjysmëzanores apo të zanoreve të shkurtra, pa përjashtuar rastet e përmendura:

Në fshatra*flli*q*shlla**pshtyj**pleq*ní**Në qytet***full*íq*shëlla*:*bësh*týj*pleq*(ë)ní

Me theks nistor në të folmen e qarkut Elbasan janë edhe fjalët e mbetura në leksik nga turqishtja si: *xhé*zme, *ká*fe, *té*qe, *sé*ne, *sá*te (*sá*de), *há*llv (*a*), *há*tlla, *bá*xho, *xhá*de, si dhe *kám*je, *táb*ëll, *há*zër, *ká*lla (*mashtrova*, *gën*jeva), *hí*le, *káng*jella etj. Me theks nistor, në të folmen e disa fshatrave, e pothuajse në pjesën më të madhe të krahinës së *Shpatit*, përdoret edhe përemri vetor i vetës së tretë njëjës, -*áj*- (*ai*). Si rezultat i këtij theksimi, kemi dhe shndërrimin e zanores së shkurtër -*i*-, në hundoren -*j*- (me këtë tingull del edhe emri *vlláj*). Ky fenomen haset edhe në disa të folme të gegërishtes qendrore e ndikuar nga ajo jugore, të cilën na e pasqyron studimi “*E folmja e Durrësit dhe e rrethinave të tij*” nga Mehmet Çeliku ku thuhet: “Përemri *ai* herë ka të theksuar elementin e parë, herë të dytin (*ai*, *áj*). Këtë luhatje e kemi hasur edhe në të folme të tjera të gegërishtes jugore, çka lidhet me funksionin e përemrit dhe me topikën e tij.”⁶

Me theks parafundor dalin fjalët: *tenxhé*re, *penxhé*re, *livé*re, *qebgjí*re. Me theks fundor, dalin fjalët të cilat tregojnë profesione kur u vihet mbaresa -*xhi*- si: *kallajxhí*, *bakërrxhí*, *samarxhí*, *mullixhí*, *teneqexhí*, *kafexhí*, *bojaxhí*, *qeleshexhi*, *briskaxhi*. Si rezultat i profesioneve, në qytetin e Elbasanit disa prej tyre kanë mbetur për mbiemra fisesh si: *Kallajxhiu*, *Bakri*, *Samarxhiu*, *Mullisi*, *Kafexhiu*, *Brisku*. Në disa fjalë, tema e të cilave mbaron me mbylltoren -*t*- si: *kurbet*, *inat*, *sahat*, *sebep*, etj., në emërtim marrin mbaresën -

⁶ ASH e RPSSH, IGJL, Dialektologjia Shqiptare VI, Mehmet Çeliku, *E folmja e qytetit të Durrësit dhe e rrethinave të tij*, f. 289.

çi-, e cila sjell edhe zhvendosjen e theksit në zanoren e fundit: *kurbetçi, inatçi, shahatçi, sebepçi*.

Në të folmen e qarkut Elbasan, përgjithësisht këto janë format e theksit të fjalëve, përjashtuar për disa raste të folmen e Polisit, i cili duke u ndodhur gjeografikisht në jug të qarkut dhe bën pjesë në atë që e quajmë zonë kalimtare dialektore, si faktor i ndikimit të toskërishtes, disa nga shembujt e mësipërm dalin me zhvendosje të theksit, si:

E folmja e Polisit⁷

xhadé

baxhá

sefté

tazé

xhybé

okllaî

Elbasan dhe fshatra të tjerë

xháde

báxho

séfte

táze

xhýbe

o(a)klláj

Në studimin “*Shtresëzime dhe risi gjuhësore në qytetin e Lezhës*” Gjovalin Shkurtaj thekson: “Për arsyet e njohura historiko-shoqërore shumë nga qytetet tona paraqiten sot me zyrtarizim të ri e në formim e sipër. Në mjaft prej tyre ndeshemi me bashkësi të përbëra (komplekse) folësish, ku, mbi bazën e zanafillës së tyre, mund të veçohen edhe disa grupe më përfaqësimitare, që ruajnë ende sisteme të ndryshme dialektore, të pranëvëna në të njëjtin mjedis, në një qytet...”⁸

Në sistemin e zanoreve në të folmen e Elbasanit si dhe në fshatrat që përmbledh ky qark, ashtu si në mbarë gegërishten, kemi tri shkallë të zanoreve, të *gjata*, të *mesme* e të *shkurtra*.

Në këtë të folme krahasuar me gjuhën standarde, zakonisht kemi rënie të zanores -ë- në fund të fjalëve si p.sh.: *pun* (punë), *gjum* (gjumë), *kam* (këmbë), *dham* (dhëmbë), *dhëmall* (dhëmballë), *dan* (darë), etj. ku si rezultat, zanoret e theksuara, për efekt kompensimi, në të pashquarën, bëhen më të gjata: *pu:n*, *gju:m*, *ka:m*, *dhëma:ll*, *dha:m*, *da:n*. Ndërsa në trajtën e shquar, me vendosjen e mbaresës trajtëformuese sipas gjinisë përkatëse, këto zanore marrin tingull normal, apo të mesëm: *puna*, *gjumi*, *kama* (këmbe), *dhëmall* (dhëmballa), *dhami* (dhëmbi), *dana* (dara).

Rënie të zanores së patheksuar -ë- në të folmen e Elbasanit dhe fshatrave, kemi edhe në disa raste në trup të fjalës, kur paraprihet nga bashkëtingëlloret e

⁷ ASH e RPSSH, IGJ-L, Dialektologjia Shqiptare V, Qemal Haxhihasani, *Vëzhgime rreth të folmes së Polisit*, f. 96.

⁸ Akademia e Shkencave e RPSSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Gjovalin Shkurtaj, *Shtresëzime dhe risi gjuhësore në qytetin e Lezhës*, Studime Filologjike 2, Viti XXXVIII (XXI), Tiranë 1984, f. 75.

shurdhëta -k- e -c-, si dhe -dh-, -r- e -rr-, apo fërkimoret -f-, -v-, p.sh.: *kmish* (këmishë), *përcëlloj* (përcëlloj), *dhmall* (dhëmballë), *njers*, (njerëz: këtë përdorim e hasim vetëm në të folmen e fshatrave), *rrxoj* (rrëzoj) *vlla* (vëlla), *përvloj* (përvëloj) *flli* (fëlli) etj.

Në varësi të trajtës, në disa emra, kemi ndryshim të gjatësisë së zanoreve, në rastet kur këto tregojnë një vend, si p.sh.: *n'mu:r* (në mur), *n'gu:r* (mbi gur), *n'gro:p* (në gropë), *n'py:ll* (në pyll) etj. Në trajtën e shquar, si në të folmen e qytetit ashtu edhe të fshatrave këto dalin fonetikisht të njëjta me të gjuhës standarde: *muri*, *guri*, *gropa*, *pylli*, duke përjashtuar disa raste, ku mund të hasim hundorëzim jo të theksuar në të folmen e disa fshatrave.

Emrat e sipërpërmendur në të pashquarën, për të njëjtin përdorim, në të folmen e fshatrave u shtohet edhe mbylltorja -t-, e cila sjell edhe ndryshimin e gjatësisë së zanoreve të theksuara, nga të gjata në të folmen e qytetit, në të shkurtra në të folmen e fshatrave: *n'murt*, *n'gurt*, *n'gropt*, *n'pyllt*.

Në studimin e Gjovalin Shkurtajt “*E folmja e Kelmendit*”, në lidhje me zanoret e gjata na parashtrohet: “...për arsye se siç është vënë në dukje me të drejtë nga E. Çabej e M. Çeliku, gjatësia e zanoreve të theksuara është një përzierje e sistemit të vjetër të gjatësisë së hershme me tipin e ri të gjatësisë kompensatore. Po mbi të gjitha vështirësinë më të madhe e përbën fakti që «edhe brendapërbrenda një të folme je ekzistojnë ndryshime mjaft të mëdha të shkallëve të gjatësisë së zanoreve të theksuara në të njëjtat forma gramatikore, madje herë-herë në të njëjtin pozicion fonetik».”⁹

Dukuri tjetër që ndikon në formimin e zanoreve të gjata në këtë të folme, është edhe reduktimi i diftongjeve, ose siç themi ndryshe monoftongimi i zanoreve si p.sh. rastet: *blu:j* (bluaj), *kr:uj* (kruaj), *shkru:j* (shkruaj), *kalu:r* (përdoret në fshatra ende, për fjalën: -kaluar-), *mul:u* (mbuluar), *harxhu:* (harxhuar) *fy:ll* (fyell), *di:ll* (diell), *bu:ll* (buall) *mi:ll* (miell), etj.

Zanoret e mesme hasen në pjesën më të madhe të leksikut në këtë të folme: *punoj*, *ngarkoj*, *shkarkoj*, *përdor*, *prashis*, *vadis*, *vjel*, *shtroj*, *jorgan*, etj.

Zanoret e shkurtra hasen në fjalë me rrokje të mbyllur si p.sh.: *e.lb*, *qe.lb*, *kna.q*, *gjy.m*, *lu.g*, *kru.*, *bufe.*, *drru.*, *hu.*, *ty.m*, etj.

Zanoret e hundorëzuara: Në të folmen e qytetit të Elbasanit këto lloj zanorësh nuk janë pjesë fonetike, ndërsa në të folmen e fshatrave janë të pranishme. Hundorëzim më të dukshëm (në fshatra) ka zanorja -a- e theksuar, e cila në shumë raste merr ngjyrim fonetik të zanores -o-, p.sh.: *bâj*, *qâj/r*, *bâr* (bërë), *belâ*, *kalamâ*, *mâ* (më), *zâ* (zë), *qânka* (*qenka*), *bzâj*, *matân*, etj.

Në të folmen e qytetit të Elbasanit, zanorja johundore -a- e theksuar, nuk pëson ndryshime nga ndikimi paraprirës i fonemave -m- dhe -n-, siç ndodh në

⁹ ASH e RPSSH, IGJL, Dialektologjia Shqiptare III, Gjovalin Shkurtajt, *E folmja e Kelmendit*, f. 15.

të folmet e tjera të gegërishtes jugperëndimore që ka nxjerrë në pah në studimin: “*Të folmet e Durrësit dhe e rrethinave të tij*”, Mehmet Çeliku, i cili kumton: “Sikurse edhe në të folmet e tjera të gegërishtes jugperëndimore, si në të folmen e Peqinit, të Ndroqit e Pezës, të Kavajës, edhe në Durrës zanorja e theksuar johundore *a*, që prihet nga bashkëtingëlloret *m*, *n* është buzorëzuar në *o* (në disa raste dëgjohej varianti *a*^o, një *a* buzore): *gamor*, *damota*, *mol*, *molli*, *moshkull*...”¹⁰.

Në të folmen e qytetit Elbasan, duke iu referuar shembujve të sjellë nga M. Çeliku këto fjalë fonetikisht dalin: *gomar*, *domate*, *mal*, *mall*, *maskull*... të cilat siç e vëmë re, dalin me *-a-* fonetikisht të pastër, ndërsa në të folmen e fshatrave, ajo ruan hundorëzim pa krijuar buzorëzim të mirëfilltë. Po kështu, edhe në rastet kur kjo zanore nuk është e theksuar, në të folmen e Elbasanit nuk pëson ndryshime. Nuk pësojnë ndryshime edhe zanoret e tjera të patheksuara.

Në të folmen e Elbasanit, karakteristikë është përdorimi i fonemës *-n-*, në ato fjalë që toskërishtja është e ndikuar nga rotacizmi. Kjo dukuri është e pranishme si në emra të gjinisë mashkullore ashtu edhe në ato femërorë, në mbiemra, folje e përemra: *mullíni* (mulliri), *ullíni* (ulliri), *rrëpína* (rrëpira), *egërsína* (egërsira), *i májmun* (i majmur), *i véshun* (i veshur), *zúna* (zura), *vúna* (vura), *atýne* (atyre), *këtyne* (këtyre) etj. Në disa raste kemi rotacizëm dhe shndërrim të zanores së patheksuar *-ë-* në *-a-* si p.sh.: *rána* (rëra), *báni* (bëri), *gërshána* (gërshëra), *záni* (zëri) etj. Në një pjesë të fshatrave në jug të qarkut, si dhe në zonën e Shpatit, kemi shfaqje të ndryshimit të *n* në *r*, si dhe hundorëzimi i zanoreve të theksuara, ku zanoret *-a-* dhe *-u-*, marrin trajtën jo të plotë të zanores *-o-*: *zâri*, *bâri*, *gërshâr*, *kam qâr* (*kam qenë*), *kam zâr* (*kam zënë*), *kûpto*, *j*, *mûllar*, *kullûr* (kulluar) *zûri* (zuri, kapi dikë a diçka) etj. Në disa raste po në të folmen e fshatrave, ndodh rënia e zanores *-ë-* të patheksuar, si dhe hundorëzimi i zanores së theksuar: *rrpîr* (rrëpirë), *rrshîr* (rrëshirë), *kushrî* (kushëri), *âsh(t)* (është), *shllîr* (shëllirë) etj.

Grupet *-mb*, *nd* dhe *ng-* të shqipes standarde janë të reduktuar në njërën nga fonemat përbërëse: *mleth* (mbledh), *maj* (mbaj), *baj* (mbaj, sistemoj), *daj* (ndaj), *nërtoj* (ndërtoj), *nel* (ngel), *nul* (ngul) etj.

Tek folja *-mleth-* (sipas të folmes së Elbasanit), vëmë re dhe zëvendësim të shtegores *-dh-* me atë *-th-*. Ky fenomen ndodh në foljet e veprimt të cilat në të tashmen dhe të ardhmen, marrin mbaresën *-dh-*, p.sh.: *heth*, *derth*, *përdreth*, *përmleth*, *vjeth* etj., porse në të shkuarën ato marrin sërish *-dh-*. Kjo dukuri fonetike ka mbetur në mosha të vjetra, si dhe në një pjesë të madhe tek të folmet e fshatrave. Nga moshat e reja të qytetit, me përjashtime të donjë rasti,

¹⁰ ASH e RPSSH, IGJ-L, Dialektologjia Shqiptare VI, Mehmet Çeliku, *E folmja e qytetit të Durrësit dhe e rrethinave të tij*, f. 292.

tashmë përdoren në fund me *-dh-*, e cila është e njëjtë me rregullin e gjuhës standarde.

Duhet të themi gjithashtu se, një pjesë e fshatrave qark qytetit, apo dhe të tjerë larg tij, kanë disa tipare të përziera dialektore. Këto vihen re në folje që kanë në trup togun *-ye-* si dhe në foljet që në vetën e parë njëjës të gjuhës standarde mbarojnë me *-rë-* ose *-në-*. Në rastin e parë, togu *-ye-* monoftongohet në *-y-*, zanore e cila merr gjatësi tingulli dhe trajtë hundorëzuese, p.sh.: *ushqÿ:r* (ushqyer), *pëlqÿ:r* (pëlqyer), *lÿ:r* (lyer), *shpërblÿ:r* (shpërblyer), *kapërcÿ:r* (kapërcyer) *përly:r* (përlyer) etj. Në rastin e dytë si p.sh. në foljet: *bërë*, *zënë*, *larë*, *prerë*, *vënë*, *shtënë*, *blerë* etj., në formën dialektore na përftohen fonetikusht: *bâr*, *zâr*, *lâr*, *prêr*, *vâr*, *shtâr*, *blâr*, ku në disa raste zanorja *-a-* e theksuar buzorëzohet. Në të folmen e qytetit në foljen *-bërë-*, kemi rënie të mbarese *-rë-*, si dhe shndërrim të zanores *-ë-* në *-a-* karakteristike kjo për gegërishten. Në foljet *-larë*, *prerë*, *blerë-* kemi sërish rënie të kësaj mbarese, por pa ndryshim të zanoreve, të cilat në këto raste dalin zanore të shkurtra: *la*, *pre*, *ble*. Në foljet *-zënë*, *vënë-* kemi rënie të zanores *-ë-* në fund të fjalës si dhe shndërrim në *-a-* të asaj që ndodhet në trup të saj. Tek folja *-shtënë-* veç rënies së mbaresës *-në-*, zanorja *-ë-* shndërrohet në *-i-* të shkurtër: *shti/va*.

Siç e vëmë re nga shembujt e mësipërm, e folmja e qytetit mbetet jashtë ndikimit dialektor të zonës kalimtare sikundër ndodh me disa fshatra përfshirë këtu edhe një pjesë të krahinës së Shpatit. Në: “*Dukuri fonetike në sistemin e zanoreve të së folmes së qytetit të Elbasanit*” Xheladin Gosturani thotë: “*Zhvillimi i qytetit të Elbasanit, ashtu sikurse zhvillimi i të gjitha qyteteve të vendit tonë, jo vetëm me rritjen natyrore të popullsisë, por edhe me shtimin mekanik, d.m.th., me shpërngulje të popullsisë nga fshati në qytet dhe me lëvizje të popullsisë qytetare nga një qytet në tjetrin, duke u krijuar kështu qytete me popullsi të përzier...*”

Në rrjedhë të kohëve në këtë qytet është derdhur edhe një popullsi nga fshatrat e krahinat përreth si nga Kërraba, Zaranika, Shpati, Peqini etj., duke sjellë me vete trajta, dukuri fonetike të të folmes nga kanë ardhur.

...Megjithëse ka pasur kontakte të vazhdueshme me zona e fshatra përreth, megjithëse aty herë pas here është derdhur një popullsi nga të gjitha trevat, prapëseprapë në qytetin e Elbasanit rron e jeton një popullsi brez pas brezi vendase. Ekziston kështu një e folme me veçori e fizionomi të sajat. Përshkrimi i saj na lejon të diktojmë dukuri fonetike e morfologjike, njësi sintaksore, fjalë e frazeologjizma me interes të posaçëm për dialektologjinë, për historinë gjuhës, si edhe për gramatikën e leksikun e sotëm të gjuhës sonë.”¹¹

¹¹ ASHSH, IGJ-L, Xheladin Gosturani, *Struktura gramatikore e së folmes së qytetit të Elbasanit dhe leksiku i saj*, DILAETOLOGJIA SHQIPTARE VII, Tiranë 2005, f. 13-14.

Përfundime

E folmja e qyteti të Elbasanit është pjesë e *dialektit të gegërishtes*, si nëndialekt është *gegërishtja jugore* dhe në grupet e të folmeve i përket *gegërishtja Shqipërisë së Mesme*. Këtë përcaktim e merr nga karakteristikat e shumta fonetike, morfologjike dhe leksikore.

Pjesa më e madhe e fshatrave që përfshin ky qark i përkasin zonës kalimtare të dialekteve, por ashtu si dhe qyteti, pavarësisht ndërthurjes së kulturave në përgjithësi e asaj gjuhësore në veçanti, kanë ruajtur bazën e tyre të të folmes.

Kemi parashtruar ndryshimet apo të përbashkëtat tingullore të zanoreve me të folme të tjera, fqinje me elbasanishten: “Në të folmen e Elbasanit, ashtu si edhe në të folmet e tjera të Shqipërisë së Mesme e sidomos të Tiranës o-ja gojore e shkurtër nuk del në rrokje nistore të hapur, në vend të saj del zanorja *a*: *aficer axhak, katec, dallap, daktor, damote*.

Fonema *i*. Në të folmet Elbasanit, ashtu edhe të Tiranës, ku në vend të kësaj zanoreje del *y*-ja në ato fjalë ku gjendet para një bashkëtingëlloreje buzore *b, p, m*: *rryp* “rip”, *lyp* “lip”, *qylm* “qilim”, *kryp* “kripë”, *ly:m* “limë”.

Midis gegërishtes dhe toskërishtes, veç rotacizmit dhe veçorive të tjera dalluese, është edhe ndryshimi i vendit të theksit duke bërë dallimin: “Në toskërisht fjalët që janë huazuar nga turqishtja kanë theksin në fund të fjalës si: *kafé, penxheré, çifté, gajdé, havalé, dyshemé* etj., ndërsa në gegërisht ka kaluar në theksin e parafundit.

Në të folmen e Elbasanit, theksi i fjalëve ndjek rregullin e përgjithshëm brenda shqipes, me theks dinamik parafundor, pa përjashtuar rastet kur ky theks lëviz, si rezultat e zhvillimeve apo veçorisë së brendshme të gjuhës.

Po kështu si shkak i theksit dinamik ..., në këto të folme (si në fshat e qytet), kemi rënie të gjysmëzanores -ë- veçanërisht në të folmen e fshatrave të këtij qarku -*flliq-, -knaq-, -bzaj-, -shlla-, -knoj-, -pshtyj/n-*, etj., fenomen që ndodh edhe në një pjesë leksikore të të folmes së qytetit si p.sh.: *planc* (plëndës), *lçoj* (lëshoj), *kpus* (këpus), *pkuc* (këpucë) *knaq* (kënaq) etj.

Ndryshime ka dhe midis të folmes së qytetit me atë të fshatrave. Folja -*dal-* në të folmen e qytetit të Elbasanit, është e njëjtë me zgjedhimin e saj në gjuhën standarde, ndërsa në të folmen e fshatrave në përgjithësi, veta e I dhe II e njëjësit bëjnë -*dal, del-*, e njëjtë me të folmen e qytetit dhe gjuhës standarde, dhe në vetën III njëjës si dhe tri vetat e shumësit kemi: *dul, dulëm, dulët, dulën*, si rezultat i monoftongimit gradual të togut zanor -*ue-* në -*u-*. Kjo formë ka qenë përdorim i vjetër në të folmen e qytetit, e cila sot haset pak tek disa të rinj si ndikim i kulturës familjare, dhe në mosha mbi shtatëdhjetë vjeç është më i përhapur.

Nga kërkimet e gjurmëve dhe fakteve, si për nga rrjedha historike e shumë ngjarjeve, ka gjëra të cilat në rrafshin gjuhësor kanë ende shumë punë, mund dhe kohë për të zbardhur, gjë të cilën, pavarësisht kësaj sakrifice, në një të ardhme të shpejtë do ta vazhdojmë me këmbëngulje, e të sjellim aq sa mundemi në sipërfaqe, ato të cilat janë mbuluar nga thellësia e viteve.